



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2020 – Numri: 183

Tiranë – E enjte, 15 tetor 2020

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 797, datë 12.10.2020	Për disa ndryshime në vendimin nr. 654, datë 14.9.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencisë së Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara”, të ndryshuar..... 12601
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 799, datë 12.10.2020	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Ndërtimi i segmentit rrugor Maqellarë–Peshkopi”..... 12607
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 800, datë 12.10.2020	Për një ndryshim në vendimin nr. 431, datë 26.6.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit ‘Rikualifikimi i sheshit ‘Italia’, Tiranë’”..... 12609
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 802, datë 12.10.2020	Për miratimin e ndryshimit të statusit nga kategoria e resursit “tokë bujqësore” në “tokë urbane” truall, të një sipërfaqeje në pasurinë me numër 171/54 dhe të një sipërfaqeje në pasurinë me numër 171/60, zona kadastrale 3737, Bashkia Roskovec..... 12609
Rregullore e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 3, datë 12.10.2020	Për detajimin e rregullave në lidhje me përcaktimin e madhësisë së syzës dhe vlerësimin e trashësisë së fijes në rrjetat e peshkimit..... 12616
	Vendim (i shkurtuar) për shpalljen të vdekur të shtetasit Petro Rondo.. 12632

**VENDIM**

Nr. 797, datë 12.10.2020

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 654, DATË 14.9.2016, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE ORGANIKËS SË AGJENCISË SË OFRIMIT TË SHËRBIMEVE PUBLIKE TË INTEGRUARA”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 17, të ligjit nr. 13/2016, “Për mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike në sportel në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 654, datë 14.9.2016, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

1. Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:


“3. Numri i punonjësve të Agjencisë së Ofritit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA) të jetë, gjithsej, 185 veta.”.

2. Shtojca I, që përmendet në pikën 1, zëvendësohet me shtojcën I, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Shtojca II, që përmendet në pikën 2, zëvendësohet me shtojcën II, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

SHTOJCA I



SHTOJCA II

ORGANIGRAMA E AGJENCISË SË OFRIMIT TË SHËRBIMEVE PUBLIKE TË INTEGRUARA (ADISA)

	KATEGORIA	POZICIONI
I. DREJTOR EKZEKUTIV (TITULLAR I INSTITUCIONIT)	II- a	1
KOORDINATOR ANTIKORRUPSION	II-b	(1)
SEKTORI I AUDITIT		(3)
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a/1	1
SPECIALIST	IV-a	2
SEKTORI I KËRKIMIT DHE INOVACIONIT/ADISA LAB		(3)
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a/1	1
SPECIALIST	IV-a	2
II. DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TË QENDRAVE		(13)
DREJTOR	II-b	1
SEKTORI I PLANIFIKIMIT DHE MENAXHIMIT TE PROJEKTEVE		(3)
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a/1	1
SPECIALIST	IV-a	2
SEKTORI I KOMUNIKIMIT ME QYTETARIN		(4)
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a/1	1



SPECIALIST	IV-a	3
SEKTORI I MBIKËQYRJES SË LEVRIMIT TË SHËRBIMEVE PËRGJEGJËS SEKTORI SPECIALIST	III-a/1 IV-a	(5) 1 4
III. DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TË BRENDSHËM		(13)
DREJTOR	II-b	1
SEKTORI JURIDIK PËRGJEGJËS SEKTORI SPECIALIST	III-a/1 IV-a	(4) 1 3
SEKTORI I SHËRBIMEVE MBËSHITËTËSE PËRGJEGJËS SEKTORI SPECIALIST PUNONJËSE PASTRIMI MAGAZINIER/MIRËMBATJE	III-a/1 IV-a I VI	(4) 1 1 1 1
SEKTORI I BURIMEVE NJERËZORE DHE PROTOKOLLIT PËRGJEGJËS SEKTORI SPECIALIST SPECIALIST ARKIV-PROTOKOLL	III-a/1 IV-a IV-b	(4) 1 2 1
IV. DREJTORIA E ZHVILLIMIT TE SHERBIMEVE		(13)
DREJTOR	II-b	1



SEKTORI I RI-INXHINIERIMIT DHE ZHVILLIMIT TË STANDARDEVE PËRGJEGJËS SEKTORI SPECIALIST	III-a/1 IV-a	(4) 1 3
SEKTORI I TRAJNIMEVE DHE MENAXHIMIT TË NJOHURIVE PËRGJEGJËS SEKTORI SPECIALIST	III-a/1 IV-a	(3) 1 2
SEKTORI I PERFORMANCËS DHE STATISTIKAVE PËRGJEGJËS SEKTORI SPECIALIST	III-a/1 IV-a	(5) 1 4
V. DREJTORIA EKONOMIKE		(10)
DREJTOR	II-b	1
SEKTORI I FINANCËS PËRGJEGJËS SEKTORI SPECIALIST	III-a/1 IV-a	(3) 1 2
SEKTORI I INVESTIMEVE PËRGJEGJËS SEKTORI SPECIALIST	III-a/1 IV-a	(3) 1 2
SEKTORI I PROKURIMEVE PËRGJEGJËS SEKTORI SPECIALIST	III-a/1 IV-a	(3) 1 2
VI. ZYRAT RAJONALE/VENDORE		(128)



ZYRA RAJONALE TIRANË			
PËRGJEGJËS ZYRE	III-b	(27)	1
SPECIALIST	IV-b		22
PUNONJËS PASTRIMI	I		2
SHOFER	IV		1
MIRËMBAJTËS	IV		1
ZYRA VENDORE KAVAJË		(10)	
PËRGJEGJËS ZYRE	IV-a		1
SPECIALIST	IV-c		8
PUNONJËS PASTRIMI	I		1
ZYRA RAJONALE FIER		(19)	
PËRGJEGJËS ZYRE	III-b		1
SPECIALIST	IV-b		16
PUNONJËS PASTRIMI	I		1
SHOFER	IV		1
ZYRA VENDORE KRUJË		(9)	
PËRGJEGJËS ZYRE	IV-a		1
SPECIALIST	IV-c		7
PUNONJËS PASTRIMI	I		1
ZYRA RAJONALE GJIROKASTËR		(13)	
PËRGJEGJËS ZYRE	III-b		1
SPECIALIST	IV-b		10
PUNONJËS PASTRIMI	I		1
MIRËMBAJTËS	IV		1
ZYRA RAJONALE SHKODËR		(14)	
PËRGJEGJËS ZYRE	III-b		1
SPECIALIST	IV-b		11



PUNONJËS PASTRIMI SHOFER	I IV	1 1
ZYRA VENDORE MALIQ		(2)
PËRGJEGJËS ZYRE SPECIALIST	IV-a IV-c	1 1
ZYRA VENDORE LUSHNJË		(9)
PËRGJEGJËS ZYRE SPECIALIST	IV-a IV-c	1 7
PUNONJËS PASTRIMI	I	1
ZYRA RAJONALE ELBASAN		(13)
PËRGJEGJËS ZYRE SPECIALIST	III-b IV-b	1 11
PUNONJËS PASTRIMI	I	1
ZYRA RAJONALE KUKËS		(2)
PËRGJEGJËS ZYRE SPECIALIST	III-b IV-b	1 1
ZYRA VENDORE KAMËZ		(10)
PËRGJEGJËS ZYRE SPECIALIST	IV-a IV-c	1 8
PUNONJËS PASTRIMI	I	1

**VENDIM****Nr. 799, datë 12.10.2020****PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE, TË
PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË
PRIVATE, QË PREKEN NGA
REALIZIMI I PROJEKTIT “NDËRTIMI I
SEGMENTIT RRUGOR MAQELLARË–
PESHKOPI”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 88/2019, “Për buxhetin e vitit 2019”, të ndryshuar, dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik të pronarëve, të pasurive të paluajtshme, pronë private që preken nga realizimi i projektit “Ndërtimi i segmentit rrugor Maqellarë - Peshkopi”.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen për pasuritë e llojit “tokë arë” dhe kultura bujqësore “drufrutorë”, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, me një vlerë të përgjithshme prej 1 198 195 (një milion e njëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e njëqind e nëntëdhjetë e pesë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit për pasuritë e llojit “tokë arë” dhe kultura bujqësore “drufrutorë”, me vlerë 1 198 195 (një milion e njëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e njëqind e nëntëdhjetë e pesë) lekë, do të përballohet nga

buxheti i vitit 2020, miratuar për Autoritetin Rrugor Shqiptar.

5. Shpenzimet procedural, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

6. Afati i përfundimit të shpronësimit të jetë brenda tre muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

7. Pronarët e pasqyruar në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar.

8. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Dibër, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Autoritetin Rrugor Shqiptar, të fillojë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar dhe të bëjë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.

9. Afati i përfundimit të punimeve të jetë në përputhje me afatet e parashikuara.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Dibër, të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit dhe kalimi i pronësisë në favor të shtetit për pasuritë e shpronësuara.

11. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, dhe Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Dibër për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR**Erion Braçe**



LISTA E PRONARËVE TË PASURIVE, PRONË PRIVATE, QË SHPRONËSOHEN NGA REALIZIMI I PROJEKTTIT NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR “MAQELLARË–PESHKOPIT”

VLERËSIMI I PASURISË SË LLOJIT “TOKË ARË”, ËSHTË KRYER BAZUAR NË VKM-në NR. 89, DATË 3.2.2016

VLERËSIMI I KULTURAVE BUJQËSORE E DRUFRUTORE ËSHTË KRYER BAZUAR NË UDHËZIMIN NR. 1, DATË 5.10.2000, I MINISTRISË SË BUJQËSISË DHE USHQIMIT

Nr.	Emër Mbiemër	Lloji i pasurisë	Z.K.	Nr. i pasurisë	Sip. totale m²	Sip. e shpronësuar m²	Çmimi lekë/m²	Vlera e tokës arë në lekë	Kultura bujqësore Vlera në Lekë	Vlera totale në lekë	Adresa	Shënime
1	Ramadan Dine Koreni	Tokë arë	2940	144/2	2375	1	115	115		115	Njësia Administrative Maqellarë	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
2	Agush Dine Koreni	Tokë arë	2940	152	5750	1715	115	197225	304091	501316	Njësia Administrative Maqellarë	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
3	Nuredin Emin Kërçishta	Tokë arë	2940	161/2	1250	371	115	42665	133040	175705	Njësia Administrative Maqellarë	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
4	Myfit Haxhi Xhari	Tokë arë	2940	161/4	1000	227	115	26105		26105	Njësia Administrative Maqellarë	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
5	Qemal Tofik Xhari	Tokë arë	2940	193/1	2000	693	115	79695	212210	291905	Njësia Administrative Maqellarë	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
6	Lavdrim Rushit Isaku	Tokë arë	2940	162/3	1500	31	115	3565		3565	Njësia Administrative Maqellarë	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
7	Ismet Rushit Isaku	Tokë arë	2940	162/2	1600	26	115	2990	2259	5249	Njësia Administrative Maqellarë	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
8	Nuredin Emin Kërçishta	Tokë arë	2940	200	2000	826	115	94990		94990	Njësia Administrative Maqellarë	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
9	Baudin Tosum Spahiu	Tokë arë	2940	205	3125	863	115	99245		99245	Njësia Administrative Maqellarë	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
VLERË TOTALE						4753		546595	651600	1198195		



VENDIM

Nr. 800, datë 12.10.2020

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.431, DATË 26.6.2019, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT ‘RIKUALIFIKIMI I SHESHIT ‘ITALIA’, TIRANË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr.88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shkronja “b”, e pikës 4, të vendimit nr. 431, datë 26.6.2019, të Këshillit të Ministrave, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“b) Fondi prej 67 402 334 (gjashtëdhjetë e shtatë milionë e katërqind e dy mijë e treqind e tridhjetë e katër) lekësh, nga fondet e buxhetit të vitit 2020, miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.”.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe**

VENDIM

Nr. 802, datë 12.10.2020

PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË STATUSIT NGA KATEGORIA E RESURISIT “TOKË BUJQËSORE” NË “TOKË URBANE” TRUALL, TË NJË SIPËRFAQEJE NË PASURINË ME NUMËR 171/54 DHE TË NJË SIPËRFAQEJE NË PASURINË ME NUMËR 171/60, ZONA KADASTRALE 3737, BASHKIA ROSKOVEC

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5/2, të nenit 11/1, të ligjit nr. 8752, datë 26.3.2001, “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e ndryshimit të statusit nga kategoria e resursit “tokë bujqësore” në “tokë urbane”, truall, të një sipërfaqeje prej 40 (dyzet) m² të pasurisë me numër 171/60 dhe të një sipërfaqeje prej 833.6 (tetëqind e tridhjetë e tre pikë gjashtë) m², të pasurisë me numër 171/54, zona kadastrale 3737, Bashkia Roskovec, sipas certifikatës së pasurisë, hartës treguese dhe lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

2. Drejtoria e Administrimit dhe e Mbrojtjes së Tokës, qarku Fier, të pasqyrojë në dokumentacionin kadastral (LN) ndryshimin e resursit nga “tokë bujqësore” në “tokë urbane”, për sipërfaqen ndërtimore sipas lidhjes nr. 1, të pasurive me numër 171/54 dhe 171/60, zona kadastrale 3737, Bashkia Roskovec.

3. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Qarkut Fier dhe Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Fier për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe**



Lidhja nr. 1

Nr. rendor	Qarku	Bashkia	Zona kadastrale	Adresa e pasurisë	Numri i pasurisë	Sipërfaqja m ²	Sipërfaqja ndërtimore m ²	Emërtimi i strukturës
1	Fier	Roskovec	3737	Velmisht	171/54	3028	833.6	Magazinë 1 kat për grumbullimin e produkteve bujqësore.
2	Fier	Roskovec	3737	Velmisht	171/60	972	40	

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZYRA E REGJISTRIMIT TE PASURISË SË PALUAJTSHME

ÇERTIFIKATË 1565571
PËR VËRTETIM PRONËSIE

Zyra e Regjistrimit Z.V.R.P.P. FIER Zona Kadastrale Nr. 3737
 Numri i Pasurisë 171/54 Volumi 10 Faqe 11
 Adresa e Pasurisë VELMISH, FIER
 Lloji i Pasurisë ARE
 Sipërfaqja Totale 3028.00 m²
 Nga kjo : Sa Truali _____ Nga kjo : Sa Ndërtesa -
 Nqs pallat : Kuota e pjesëmarrjes _____ %

KJO ÇERTIFIKATË LËSHOHET PËR TË VËRTETUAR QË

Zoti (Zotërinjtë)	Emri	Atësia	Mbiemri	Pjesa	Adresa
"RINALDI" SHPK				1/1	FIER

- është pronar i _____ pasurisë me numër 171/54
 - janë bashkëpronarë sipas pjeseve më lart _____
 - është përfaqësues i familjes e cila ka në pronësi _____
 - kufizimet e pasurisë janë : V _____, L _____, J _____, P _____

Kjo çertifikatë plotësohet në përputhje me Ligjin e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

Kjo çertifikatë lëshohet sipas kërkesës së paraqitur nga i (të) interesuari (t) më datë 5/2018 Nr. 7360

Data e lëshimit të çertifikatës 10/5/2018

Lëshuesi i çertifikatës
REGJISTRUESI
PETRIT KANANI



HARTA TREGUESE E REGJISTRIMIT

(Fragment)

ZYRA E REGJISTRIMIT
TE PASURIVE TE PALUEJTSHME
FIER

REGJISTRUES

Petrut Kanani

Vula/Firma

A. IDENTIFIKIMI I PASURISE

ZONA KADASTRALE 3737

NR. I PASURISE: 171/54

VOL 10

FQ 11

INDEKSI I HARTES: K-34-112-(185-C) SHKALLA: 1:2500

ADRESA E PASURISE: Rrethi FIER

Q/F VELMISH, FIE

Rr/L:

P/G

SH

K ___Ap

B. KUFIZIMET

V. 171/55

L. 171/60

J. 171/31


P. 171/23

C. PRONARI

"RINALDI" SHPK

D. Data: 10-May-18

Ora: 11:28:39AM

X: 394946.203
Y: 4514900.585X: 395425
Y: 4514900.5

X: 394946.203

X: 395425
Y: 4514900.5



Ministria e V.K.M. Nr. 519, Datë 7.11.1994

KARTELA E PASURISE SE PALUJTTSHME

A - SEKSIONI I IDENTIFIKIMIT TE PASURISE

Zem. Kallistuale: 3737 NR. PASURISE: 171/54 Vol. 16, Fq. 11
 Indeksi i Hartes: K-34-112-(185-C) Vjepra e Vol. 2, Fq. 68
 Adresa e Pasurisë: Rrethi FIER Q.T. VELIMIRI FIER Vjepra e Vol. 3, Fq. 68
 Ref. L. P.G. Sht. K. Ap.

B - SEKSIONI I PERSHKRIMIT TE PASURISE

Lloji i Pasurisë: ARE Brenda V.K.N. 10, Ref.:

Sip. Totale e Pasurisë	Nga Sip. Totale: sa Truall	Nga Sip. Truall: sa Ndërtes
1. 3,028.00 m ² Ref. 00000360	1. m ² Ref.	1. m ² Ref.
2. m ² Ref.	2. m ² Ref.	2. m ² Ref.
3. m ² Ref.	3. m ² Ref.	3. m ² Ref.
4. m ² Ref.	4. m ² Ref.	4. m ² Ref.

Per pjesen e perbashket:

DALLAT

Kuota e pjesemartjes: %

Nr i Pasurise (pallte):

Vol. Fq.

C - SEKSIONI I PRONESISE

Nr Dok.	Data Registrimit	Emri	Adresa	Mbështet	Nr. Paturp	I/F/B	Adresa e Prokurit	Shuma e Paguar	Data e Lesh. Certifikates	Shtetësi	Emri
0000000	10/05/2018	"RINALDI" SHPK				1	FIER	615.000	10/05/2018	KSHITJE	

PERFUNDIMTARE (data):

Problemi i vapante
 TE DHENAT E PASURISE JANE
 PERMIRISUAR/ENDITESUAR SIPAS
 NENIT 64 LIGJIT 33/2012 DT 05.09.2018
 DIFERENC DOKUMENT FAKT
 I REFEROHET PARCELES 30/5 SIPAS
 AMTP-99



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZYRA E REGJISTRIMIT TE PASURISË SË PALUAJTSHME

ÇERTIFIKATË 1565570
PËR VËRTETIM PRONËSIE

Zyra e Regjistrimit Z.V.R.P.P. FIER Zona Kadastrale Nr. 3737
 Numri i Pasurisë 171/60 Volumi 10 Faqe 34
 Adresa e Pasurisë VELMISH
 Lloji i Pasurisë ARE
 Sipërfaqja Totale 972.00 m2
 Nga kjo : Sa Truali _____ Nga kjo : Sa Ndërtesa _____
 Nqs pallat : Kuota e pjesëmarrjes _____ %

KJO ÇERTIFIKATË LËSHOHET PËR TË VËRTETUAR QË

Zoti (Zotërinjtë)

Emri	Atësia	Mbiemri	Pjesa	Adresa
"RINALDI" SHPK			1/1	FIER

- është pronar i _____ pasurisë me numër 171/60
 - janë bashkëpronarë sipas pjesëve më lart _____
 - është përfaqësues i familjes e cila ka në pronësi _____
 - kufizimet e pasurisë janë : V _____, L _____, J _____, P _____

Kjo çertifikatë plotësohet në përputhje me Ligjin e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

Kjo çertifikatë lëshohet sipas kërkesës së paraqitur nga i (të) interesuari (t) më datë 5/5/2018 . Nr. 7359

Data e lëshimit të çertifikatës 10/5/2018

Lëshuesi i çertifikatës
REGJISTRUESI



HARTA TREGUESE E REGJISTRIMIT

(Fragment)

**ZYRA E REGJISTRIMIT
TE PASURIVE TE PALUEJTSHME
FIER**

REGISTRAR
Petrut Kanani

VulafFirma

A. IDENTIFIKIMI I PASURISE

ZONA KADASTRALE 3737

NR. I PASURISE: 171/60 VOL 10 FQ 34
 INDEKSI I HARTES: K-34-112-(185-C) SHKALLA: 1:2500
 ADRESA E PASURISE: Rrethi FIER Q/F VELMISH
 Rr/L: P/G SH K Ap

B. KUFİZİMET

V. 171/59
L. 171/59
J. 171/31
P. 171/54


C. PRONARI

"RINALDI" SHPK

D. Data: 10-May-18

Ora: 11:29:34AM

X 364960 443
Y 4514907 944

X: 31
Y: 451490



Miratuar nga V. K. M. Nr. 519, Datë 7.11.1994

KARTELA E PASURISE SE DALUAJTSHME

Vol. 10, Fq. 34

A - SEKSIONI I IDENTIFIKIMIT TE PASURISE

Zona Kadastrale: 3737 NR I PASURISE: 171/00

Vijon nga Vol. 10, Fq. 30

Indeksi i Hartes: K-34-112-(185-C)

Vitet në Vol. Fq. deri në: Vol. Fq.

Adresa e Pasurisë: Rrethi FIER

Q.F. VE. MISH

PERFUNDIMTARE (data):

Rr/L.

P/G

SH

K

Ap

Përshkrim i veçantë:

B - SEKSIONI I PERSHKRIMIT TE PASURISE

Lloji i Pasurisë: ARE

Brenda V.K.N. JO

Ref:

Sip. Totale e Pasurisë:

Nga Sip. Totale: sa Trual

Nga Sip. Trual: sa Ndërtesi

1. 972.00 m²1. m²1. m²

Ref. 00000379

Ref.

Ref.

2. m²2. m²2. m²

Ref.

Ref.

Ref.

3. m²3. m²3. m²

Ref.

Ref.

Ref.

4. m²4. m²4. m²

Ref.

Ref.

Ref.

Per pjesen e përbashket:

PALLAT

Kuota e pjesmarjes:

%

Nr i Pasurise (pallat):

Vol. Faqe:

C - SEKSIONI I PRONESISE

Nr. Dok.	Data Registrimit	Emri	Atësia	Mbiemri	Nr. Pasap.	LT/B	Adresa e Pronarit	Shuma e Paguar	Data e Lësh. Certifikatës	Shënime	Firma
0/000298	10/05/2018	"RINALDI" SHPK				I	FIER	270.000	10/05/2018	K.SHTITJE	



RREGULLORE
Nr. 3, datë 12.10.2020

**PËR DETAJIMIN E RREGULLAVE NË
LIDHJE ME PËRCAKTIMIN E
MADHËSISË SË SYZES DHE
VLERËSIMIN E TRASHËSISË SË FIJES
NË RRJETAT E PESHKIMIT**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës dhe të neneve 121, pika 3 dhe 135, pika 2, të ligjit nr. 64/2012 “Për peshkimin”, të ndryshuar, ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural miraton rregulloren, si më poshtë:

KREU I
QËLLIMI DHE PËRKUFIZIMET

Neni 1
Qëllimi

Kjo rregullore detajon për inspektorët e peshkimit, mënyrën e përcaktimit të madhësisë së syzes dhe vlerësimin e trashësisë së fijos që përdoret në rrjetat e peshkimit.

Neni 2
Përkufizimet

1. Në kuptim të kësaj rregulloreje:

a) “matës i syzeve të rrjetës” është një matës i syzeve të rrjetës i pajisur me dy nofulla, i cili i aplikon automatikisht syzeve të rrjetës forca gjatësore të përfshira në intervalin 5 deri në 180 *Newton* (N), me një saktësi prej 1 N;

b) “vegël peshkimi e lëvizshme” është çdo vegël peshkimi, për të cilën aktiviteti i zënies kërkon një lëvizje aktive të vetë veglës së peshkimit. Në këtë kategori hyjnë, mes të tjerave, veglat e peshkimit me tërheqje ose me rrethim, tratat, tratat e zallit ose trata të tjera të ngjashme;

c) “vegël peshkimi fikse” është çdo vegël peshkimi, në të cilën aktiviteti i zënies nuk kërkon një lëvizje aktive të vetë veglës së peshkimit. Në këtë kategori hyjnë, mes të tjerave, rrjetat ngeçese, njicat, mrezhat, rrjetat kurthe, parangallët, parancat dhe kurthet;

ç) “drejtimi N” është për pjesët e rrjetës me syze të nyjtuara: drejtimi pingul me orientimin e

përgjithshëm të fijos së rrjetës, siç është paraqitur në shtojcën I;

d) “drejtimi T” është:

i. për pjesët e rrjetës me syze të nyjtuara: drejtimi paralel me orientimin e përgjithshëm të fijos së rrjetës, siç është paraqitur në shtojcën I;

ii. për pjesët e rrjetës pa nyje: drejtimi pingul me drejtimin N.

dh) “madhësia e syzes” është:

i. për pjesët e rrjetës me syze të nyjtuara: largësia maksimale midis dy nyjave të kundërta të së njëjtës syze, kur kjo është plotësisht e tërhequr, siç është paraqitur në shtojcën I;

ii. për pjesët e rrjetës pa nyje: largësia e brendshme midis bashkimeve të kundërta të së njëjtës syze, kur kjo është plotësisht e tërhequr përgjatë aksit më të gjatë.

e) “syze në formë rombi” është një syze si ajo e paraqitur në figurën 1, të shtojcës II, e përbërë nga katër brinjë të së njëjtës gjatësi, në të cilën dy diagonalet e syzes janë pingule dhe një diagonale është paralele me aksin gjatësor të rrjetës, siç është paraqitur në figurën 2, të shtojcës II;

ë) “syze kuadratike” është një syze katërkëndore e përbërë nga dy seri brinjësh paralele të së njëjtës gjatësi, nga të cilët njëri është paralel dhe tjetri është pingul me aksin gjatësor të rrjetës:

i. “syze T90” është syze në formë rombi nga një pjesë rrjete me syze të nyjtuara, siç është paraqitur në figurën 1, të shtojcës II, e montuar në mënyrë të tillë që drejtimi T i pjesës së rrjetës, është paralel me aksin gjatësor të rrjetës.

KREU II
MATËSIT ZYRTARË

Neni 3

**Matësi i syzeve të rrjetës dhe matësi i
trashësisë së fijos së përdredhur të rrjetës**

1. Në aktivitetin e tyre të inspektimit të aktivitetit të peshkimit, inspektorët e peshkimit përdorin një matës të syzes së rrjetës dhe të trashësisë së fijos së përdredhur të rrjetës, sipas dispozitave të kësaj rregulloreje, për përcaktimin e madhësisë së syzes dhe trashësisë së fijos së përdredhur të rrjetave të peshkimit.

2. Karakteristikat teknike që aplikohen për matësin e madhësisë së syzes janë paraqitur në shtojcën III.



3. Karakteristikat teknike që aplikohen për matësin e trashësisë së fijes së përdredhur të rrjetës janë paraqitur në shtojcën IV.

4. Matësit e madhësisë së syzeve dhe të trashësisë së fijes së përdredhur të rrjetës sipas pikës 1, mbajnë etiketën “Matës zyrtar” dhe certifikimin e prodhuesit që vërteton pajtueshmërinë me karakteristikat teknike të parashikuara respektivisht në pikat 2 dhe 3.

5. Matësit e madhësisë së syzeve dhe të trashësisë së fijes së përdredhur të rrjetës, të shitura dhe/apo të shpërndara me qëllim përdorimin nga ana e palëve ose personave të tjerë nuk duhet të mbajnë etiketën “Matës zyrtar”.

Neni 4

Instrumentet e kalibrimit për matësin e madhësisë së syzes

Peshat dhe pllakëzat e matjes, të kalibruara të paraqitura në figurën 1, të shtojcës V, certifikohen nga ministria dhe mbajnë etiketën “zyrtar”.

Neni 5

Prova e matësit të madhësisë së syzes

1. Saktësia e matësit të madhësisë së syzes verifikohet:

- duke futur nofullat e matësit në të çarat e pllakëzës së kalibrimit siç është paraqitur në figurën 1, të shtojcës V;
- duke varur peshat e kalibruara në nofullën fikse, siç është paraqitur në figurën 2, të shtojcës V.

KREU III

PËRCAKTIMI I MADHËSISË SË SYZES

Neni 6

Përzgjedhja e syzeve në veglat e lëvizshme të peshkimit

1. Inspektori përzgjedh një seri 20 syzesh të njëpasnjëshme në rrjetë, të marra sipas drejtimit të mëposhtëm:

- për syzet në formë rombi dhe syzet kuadrato, në drejtimin e aksit gjatësor të rrjetës;
- për syzet T90, pingul me drejtimin e aksit gjatësor të rrjetës.

2. Nuk duhet të maten syzet që ndodhen tre syze larg litarëve anësorë, qepjeve, kavove apo

lidhëses së thesit (bragës së mbylljes). Kjo largësi matet në drejtim pingul me qepjet, kavot apo lidhësen e thesit me rrjetën të tërhequr në drejtimin në të cilin kryhet matja. Gjithashtu, nuk maten syzet e dëmtuara ose të riparuar apo syzet në të cilat janë mbajtur dispozitivë të fiksuar në rrjetë.

3. Si përjashtim të pikës 1, nuk është e detyrueshme që syzet për t'u matur të jenë të njëpasnjëshme në rastet kur kjo është në kundërshtim me kërkesat e pikës 2.

Neni 7

Përzgjedhja e syzeve në veglat fikse të peshkimit

1. Inspektori përzgjedh 20 syze nga rrjeta e peshkimit. Në rastin e rrjetave me madhësi të ndryshme syzesh, syzet duhen përzgjedhur në pjesën e rrjetës që ka syzet me madhësi më të vogël.

2. Nga përzgjedhja e syzeve në përputhje me pikën 1, duhen përjashtuar:

- syzet e vendosura sipër, poshtë ose anash litarit anësor;
- tri syzet që janë ngjitur me kavot dhe qepjet;
- syzet e prishura ose të riparuar.

Neni 8

Përgatitja dhe përdorimi i matësit të madhësisë së syzeve

1. Matësi i madhësisë së syzeve:

- përgatitet në përputhje me shtojcën VI;
- përdoret në përputhje me shtojcën VII.

Neni 9

Përdorimi i matësit të madhësisë së syzes për matjet e syzeve në formë rombi dhe syzeve T90

1. Për matjen e syzeve në formë rombi dhe syzeve T90:

a) në pjesët e rrjetave me syze të nyjtuara ose pa nyje, në të cilat është e mundur përcaktimi i drejtimit N, rrjeta duhet të tërhiqet në drejtimin N, siç është paraqitur në shtojcën VII;

b) në pjesët e rrjetave pa nyje, në të cilat nuk është e mundur përcaktimi i drejtimit N, matet aksi më i gjatë i rrjetës.



Neni 10

Përdorimi i matësit të madhësisë së syzes së rrjetës për matjen e syzeve kuadratike

1. Për matjen e pjesëve të rrjetës me syze kuadratike, pjesa e rrjetës duhet të tërhiqet së pari në njërin drejtim diagonal dhe pastaj në sensin tjetër diagonal të syzeve, siç është paraqitur në shtojcën VIII.

2. Procedura e parashikuar në shtojcën VI, aplikohet për matjen e secilës diagonale të syzeve kuadratike.

Neni 11

Kushtet e matjes

Rrjetat maten vetëm kur ato janë të lagura por jo të ngrira.

Neni 12

Matja e madhësisë së çdo syzeje të përzgjedhur

1. Madhësia e çdo syze korrespondon me largësinë e cepave të jashtëm të nofullave të matësit në pikën kur ndalon nofulla e lëvizshme.

2. Nëse vërehen ndryshime në matjen e diagonaleve të një syze të veçantë, në syzet kuadratike përdoret diagonalja më e gjatë.

Neni 13

Përcaktimi i madhësisë së syzes së rrjetës

Madhësia e syzes së rrjetës është vlera mesatare e treguar nga matësi i madhësisë së syzeve, të një serie prej 20 syzesh të përzgjedhura.

Neni 14

Përcaktimi i madhësisë së syzes në rast kundërshtimi

1. Në rast se kapiteni i një anijeje peshkimi kundërshton rezultatin e përcaktimit të madhësisë së syzes të përcaktuar në përputhje me nenin 13, vazhdohet me përzgjedhjen dhe matjen e 20 syzeve në një pjesë tjetër të rrjetës në përputhje me nenin 6 deri në 12.

2. Madhësia e syzes së rrjetës është vlera mesatare e paraqitur nga matësi i madhësisë së rrjetës, të të gjitha 40 syzeve të përzgjedhura.

Rezultati i nxjerrë nga matësi i madhësisë së syzes konsiderohet përfundimtar.

KREU IV**PËRCAKTIMI I TRASHËSISË SË FIJES SË RRJETËS**

Neni 15

Përzgjedhja e fijos së rrjetës

1. Inspektori përzgjedh syzet nga çfarëdo pjesë e rrjetës së peshkimit për të cilën është parashikuar një trashësi maksimale e lejuar e fijos së rrjetës.

2. Nuk përzgjidhen fijet e rrjetës në ato syze që janë të dëmtuara ose të riparuar.

Neni 16

Përzgjedhja e fijeve të rrjetës në pjesët e rrjetës me syze në formë rombi

1. Në pjesët e rrjetës me syze në formë rombi, fijet zgjidhen sipas mënyrës së mëposhtme, paraqitur dhe në shtojcën VIII:

a) në rastet e rrjetave me fije të përdredhur të thjeshtë, kjo fije duhet të përzgjidhet në dy cepat e një serie prej 10 syzesh të njëpasnjëshme;

b) në rastet e rrjetave me fije të përdredhur çift, çdo fije teke e rrjetës do të përzgjidhet në dy cepat e një serie prej 5 syzesh të njëpasnjëshme.

Neni 17

Përzgjedhja e fijos së përdredhur të rrjetës në pjesët e rrjetës me syze kuadratike

1. Në pjesët e rrjetës me syze kuadratike, fijet e përdredhura zgjidhen sipas mënyrës së mëposhtme, paraqitur dhe në shtojcën VIII:

a) në rastin e rrjetës me fije të përdredhur të thjeshtë, fija përzgjidhet vetëm në njërin krah të 20 syzeve, duke zgjedhur të njëjtin krah në secilën nga syzet;

b) në rastin e rrjetave me fije të përdredhur çift, çdo fije teke e rrjetës duhet të përzgjidhet vetëm në njërin krah të 10 syzeve, duke zgjedhur të njëjtin krah në secilën nga syzet.



Neni 18

Përzgjedhja e matësit të trashësisë së fijes së rrjetës

Inspektori duhet të përdorë një matës, i cili ka vrimën qendrore me një diametër të barabartë me trashësinë maksimale të autorizuar për fijen e rrjetës, për pjesët e rrjetës të shqyrtuara.

Neni 19

Kushtet e matjes

Fijet e rrjetës nuk duhet të jenë të ngrira kur maten.

Neni 20

Përcaktimi i trashësisë së secilës fije të përdredhur të rrjetës së përzgjedhur

Nëse trashësia e fijes së përdredhur të rrjetës pengon mbylljen e nofullave të matësit ose fija e përdredhur e rrjetës nuk kalon lirshëm në vrimë kur nofullat janë të mbyllura, inspektori jep një vlerësim negativ (-) në përcaktimin e trashësisë së fijes së përdredhur të rrjetës.

Neni 21

Përcaktimi i trashësisë së fijes së përdredhur të rrjetës

1. Nëse në 20 fjet e përdredhura të rrjetës të përzgjedhura, regjistrohen më shumë se 5 vlerësime negative (-) sipas nenit 20, inspektori kryen përzgjedhjen e 20 fijeve të rrjetës të tjera në përputhje me nenet 15 deri në 20.

2. Nëse në 40 fjet e përdredhura të rrjetës të përzgjedhura, regjistrohen më shumë se 10 vlerësime negative (-), konsiderohet që trashësia e fijes së rrjetës është më e madhe se ajo e autorizuar për pjesën e rrjetës të shqyrtuar.

Neni 22

Përcaktimi i trashësisë së fijes së përdredhur të rrjetës në rast kundërshtimi

1. Në rast se kapiteni i një anijeje peshkimi kundërshton rezultatin e përcaktimit të trashësisë së fijes së përdredhur të rrjetës të matur, në përputhje me nenin 21, aplikohen dispozitat sipas pikës 2 të këtij neni.

2. Inspektori kryen përzgjedhjen dhe matjen e 20 fijeve të përdredhuratë tjera, në të njëjtën pjesë të rrjetës së peshkimit. Nëse në 20 fjet e përdredhura të përzgjedhura, regjistrohen më shumë se 5 vlerësime negative (-), konsiderohet që trashësia e fijes së përdredhur të rrjetës është më e madhe se ajo e autorizuar për pjesën e rrjetës të shqyrtuar.

KREU V**DISPOZITAT E FUNDIT**


Neni 23

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Bledar Çuçi

SHTOJCA I
MADHËSIA E SYZES, DREJTIMI N DHE DREJTIMI T I FILLIT TË PËRDREDHUR TË
RRJETËS




- 1: Madhësia e syzes.
- 2: Drejtimi T.
- 3: Orientimi i përgjithshëm i rrjetës.
- 4: Drejtimi N.

SHTOJCA II

PJESË RRJETE ME SYZE FORMË ROMBI E NYJËTUAR DHE PJESË RRJETË T90

Drejtimi i përdredhjes në një me syze në formë rombi e nyjëtuar e llojit tradicional (A) dhe një rrjet në të cilën është aplikuar një rrotullim 90° (B) tregohet në figurën e mëposhme:

Figura 1




A: Pjesë rrjete me syze formë rombi e nyjëtuar.

B: Pjesë rrjete T90.

1: Aksi gjatësor i rrjetës.

Figura 2






SHTOJCA III
SPECIFIKIMET TEKNIKE TË MATËSIT TË MADHËSISË SË RRJETËS

1. Matësi i madhësisë së syzeve të rrjetës:
 - a. aplikon automatikisht një forcë matëse gjatësore kur mat madhësinë e syzeve të rrjetave të peshkimit;
 - b. është i pajisur me dy nofulla, një fikse dhe një të lëvizshme, të cilat kanë një trashësi prej 2 milimetra dhe cepa të rrumbullakuar me një rreze prej 1 milimetri për të siguruar që nofullat të rrëshqasin lirshëm mbi fijen e përdredhur të rrjetës siç është paraqitur në figurën në vazhdim;
 - c. të punojë me energji elektrike ose me anë të baterive; në rastin e fundit ai duhet të kryejë 1.000 matje të njëpasnjëshme të madhësisë së rrjetës para se të nevojitet rikarikimi i tij;
 - ç. të jetë në gjendje të aplikojë forca gjatësore sipas përzgjedhjes në një interval nga 5 deri 180 në Newton dhe me një saktësi prej 1 Newton;
 - d. të disponojë një sistem të integruar në të për matjen e forcës që aplikohet;
 - dh. të jetë në gjendje të tërheqë një syze rrjete me një shpejtësi konstante prej 300±30 mm/min me anë të nofullës së lëvizshme;
 - e. të jetë në gjendje të masë syze të një madhësie nga 10 deri në 300 milimetra dhe të ketë nofulla të çmontueshme për përdorimin në syze të mëdha dhe të vogla;
 - ë. të ketë një saktësi matje prej 1 milimetri;
 - f. të ketë një strukturë të fortë dhe që të mos deformohet nga peshat;
 - g. të jetë i lehtë, por i fortë dhe me një peshë jo më të madhe se 2.5 kilogram;
 - gj. të jetë i përbërë nga materiale që janë rezistente ndaj gërryerjes që shkaktohet nga mjedisi detar;
 - h. të jetë i papërshkrueshëm dhe rezistent ndaj pluhurave në norma IP561];
 - i. të sigurojë një funksionim të qëndrueshëm në intervalin e temperaturave -100C deri +450C;
 - j. të jetë në gjendje t'i rezistojë temperaturave nga -300C deri +700C gjatë ruajtjes ose transportimit;
 - k. të jetë i kontrolluar nga një software që të përmbajë një menu funksionesh dhe që të mundësojë autotest-in e përbërësve mekanikë dhe elektronikë të matësit gjatë hyrjes së tij në funksionim;
 - l. të tregojë në një ekran që është i gatshëm për funksionim, në të kundërt, të shfaqë një mesazh gabimi, të fiket dhe të mos funksionojë;
 - ll. të mund futet në funksionim dhe me një dorë të vetme dhe të ketë pulsantë të jashtëm për hyrjen në funksionet e tij;
 - m. të shfaqë të dhënat në një ekran integral dhe të shfaqë çdo matje, numrin e matjeve të bëra në seri dhe vlerën mesatare në milimetra;
 - n. të ruajë të dhënat e të paktën 1.000 matjeve në memorien e tij dhe të ketë mundësinë e transmetimit të të dhënave në një kompjuter;
 - o. të përmbajë një funksion për përlogaritjen e madhësisë së syzes së rrjetës të përafruar në 0.1 milimetërshin më të afërt;



- p. të përmbajë një software që ka një funksion për përzgjedhjen automatike të diagonales më të madhe të secilës syze të rrjetës për përllogaritjen e madhësisë mesatare të syzes së rrjetës në rrjetat me syze kuadratike;
 - q. të ruajë të dhënat e të gjitha matjeve të bëra.
2. Në disa raste rrjetat deformohen nën ngarkesë. Matësi duhet të llogarisë një kusht të tillë dhe të aplikojë përsëri forcën e paracaktuar, duke përdorur një algoritëm të software të kontrollit si ai i përshkruar në shtojcë.

¹ Kodet e mbrojtjes së brendshme (IP) janë të specifikuar në normën ndërkombëtare të elektroteknikës (IEC) 60529.



Përshkrimi	
1	Nofulla fikse me bateri
2	Nofulla e lëvizshme
3	Ekrani
Specifikimet teknike	
Matja e gjatësisë	10-300 mm (milimetra)
Intervali:	± 1 mm
Saktësia:	5
Matja e forcës	-180 N (Newton)
Intervali:	± 1 N
Saktësia:	10 N, 20 N, 50 N, 125 N
Forcat e matjeve fikse:	300 ± 30 mm/min (1)
Shpejtësia e nofullës së lëvizshme:	Minimumi 1.000 matje
Autonomia e baterisë:	Të paktën 1.000 matje
Ruajtja e të dhënave	
Memoria:	
Intervali i temperaturave	Nga - 100C deri + 400C
Në funksionim:	Nga - 300C deri +700C
Në ruajtje:	Norma IP56
Papërshkueshmëria	
Rezistent ndaj goditjeve	
Pesha:	Maksimumi 2.5 kilogram
(1) Shpejtësia e nofullës së lëvizshme gjatë tërheqjes së syzës. Shpejtësia pa ngarkesë e nofullës së lëvizshme mund të jetë më e madhe.	



Algoritmi i matjes

Për të pasur parasysh deformimin e syzes së rrjetës në tërheqje:

- a. të hapet nofulla e lëvizshme brenda syzes së rrjetës me një shpejtësi konstante 300 ± 30 mm/min¹, deri në arritjen e forcës së ngarkesës;
- b. të fiket motori dhe të pritët 1 sekondë;
- c. nëse forca zbret nën 80% të forcës së paracaktuar, të hapet nofulla e lëvizshme brenda syzes derisa të arrihet edhe një herë forca e matjes.

¹ Shpejtësia e nofullës së lëvizshme gjatë tërheqjes së syzes. Shpejtësia pa ngarkesë e nofullës së lëvizshme mund të jetë më e madhe.


SHTOJCA IV

SPECIFIKIMET TEKNIKE TË MATËSIT TË TRASHËSISË SË FIJES SË PËRDREDHUR TË RRJETËS

Matësit e trashësisë së fijeve të përdredhur të rrjetës duhet të përmbushin kërkesat e mëposhtme:

- a. të jenë të prodhuar me materiale rezistente, të cilat nuk gërryhen dhe që të mund t'i rezistojnë kushteve të vështira të ambientit detar, sipas modelit të paraqitur më poshtë;
- b. vrima rrethore e përdorur për matjen e trashësisë së fijeve të përdredhur (vrime) të paraqesë nga të dy anët cepa të rrumbullakuar, me qëllim evitimin e fërkimit të fijeve të rrjetës, kur kjo e fundit futet në vrimë gjatë kontrollit;
- c. të kenë pinca në majën e tyre për të lehtësuar futjen e nofullave ndërmjet fijeve të përdredhura çift të rrjetës;
- ç. të kenë nofulla me veprim paralel aq të forta sa të mos jenë të deformueshme në kuadër të një funksionimi të arsyeshëm të tyre, duke pasur parasysh faktin që nofullat duhet të jenë të mbyllura duke ushtruar një presion manual gjatë matjeve;
- d. faqet e brendshme të nofullave janë të frezuara, në mënyrë që të lejojnë një boshllëk me thellësi 0.5 milimetra dhe gjatësi 1 milimetër në secilën anë të vrimës kur nofullat janë të mbyllura, në mënyrë që të evitohet që filamentet e veçanta që dalin nga struktura e përdredhur e fijeve të rrjetës të ngecin në sipërfaqet e sheshta të nofullave në secilën anë të vrimës në të cilën fija e përdredhur është futur;
- dh. kur nofullat të jenë të mbyllura, diametri i vrimës rrethore është i treguar në milimetra në njërin nga nofullat që i korrespondojnë vetë vrimës; nofullat janë të mbyllura kur sipërfaqet e dy pjesëve të brendshme të nofullave takohen dhe ndodhen në të njëjtin nivel;
- e. si doreza, ashtu dhe nofullat mbajnë etiketën “Matës EC”;
- ë. të ketë një tolerancë të diametrit të vrimës të barabartë me 0.1 milimetra;
- f. janë lehtësisht të manovrueshme për t'i lejuar një inspektor transportimin e një serie prej 4 matësish (4mm, 5mm, 6mm, dhe 8mm) gjatë transferimit nga njëra anije në tjetrën;
- g. matësit e dimensioneve të ndryshme të jenë lehtësisht të identifikueshëm;
- gj. të mund të futen lehtësisht midis fijeve të përdredhura çift. Pasi është pozicionuar, matësi duhet të mund të funksionojë lehtësisht me një dorë të vetme.

Skema e pincave që masin fijen e përdredhur të rrjetës:



Dimensionet dhe legjenda e disenjios							Kur nuk përdoren, pincat qëndrojnë të hapura nga një sustë shlytëse	Pamje e sheshitë	Pamje ballore	Pamje nga mbrapa	Doreza	Nofullat
A	132	B	16	C	161	D	19	E	48			



Dimensioni dhe legjenda e dimensioneve		Titulli e Notula	
A 89		b	Pompe nga mburoja
B 35		h	Pompe e vë gjithe
C 14,5		i	I emim i të gjithë cepave
D 7,5		a	Vrima mbi notulla të vendosura çift
E 6,25			
F 4-minimal			
G 40,48			
H 20,64			
I 7,0			
J 7,94			
K 3			
L 4			
M N $\frac{1}{2}$			
O 9,5			
P 6,0			
Q 1,0			
R 0,25			
S R1,5			
T N 2,0			
U da N $\frac{1}{2}$ a			
V Da N $\frac{1}{2}$ a			
W N 4,0 5,0 6,0 8,0			
X 0,10			
Y R3			
Z 0,5 x 45°			
a R1,5			
b R4			
Pompe e shtrënguar			
c Detyrë rezultuar			
d Pompe e shtrënguar e detyrë			
e Pompe nga mburoja			
f Pompe hallore			
		Toleranca Më paksimin barë ngjashmëri derivuesit decimale në figura	
		± 0,10 ± 0,50	


SHTOJCA V

KALIBRIMI DHE PROVA E MATËSIT TË MADHËSISË SË SYZES SË RRJETËS

A. Verifikimi i madhësisë të gjatësisë

Verifikimi i madhësisë së gjatësisë kryhet duke futur nofullat e matësit që do përdoret në inspektim në të çarat me gjatësi të ndryshme të pllakës së fortë të kalibrimit. Një veprim i tillë mund të kryhet në çdo moment.

Figura 1




Gjatësia e të çarave në milimetra

B. Verifikim i matjes së forcës

Verifikimi i matjes së forcës kryhet duke matur pesha të kalibruara në nofullën fikse që ka bateri, duke mbajtur pa lëvizur matësin në pozicionin vertikal. Peshat duhet të kenë një vlerë prej 10 N, 20 N, 50 N dhe 125 N dhe të përdoren vetëm në kushte të palëvizshme.

Figura 2



I: pesha e provës

SHTOJCA VI

PËRGATITJA E MATËSIT TË SYZES SË RRJETËS

1. Inspektori:

- a. përzgjedh një matës me madhësi të përshtatshme me syzet që duhet të maten;
- b. të sigurohet që nofullat të jenë të pastra;
- c. të verifikojë që matësi e kryen në mënyrë të suksesshme autotest-in;
- ç. të përzgjedhë forcën e matjes siç është treguar më poshtë:
 - i. për veglat e peshkimit të lëvizshme:
 - 20 Newton për syzet me madhësi < 35 mm;
 - 50 Newton për syzet me madhësi ≥ 35 mm dhe < 55 mm;
 - 125 Newton për syzet me madhësi ≥ 55 mm;
 - ii. për veglat e peshkimit fikse:
 - 10 Newton për të gjithë madhësitë e syzeve;
- d. të verifikojë impostimin e llojit të nofullës. Impostimi standard i korrespondon “normales”. Nëse përdoren nofulla të madhësisë më të madhe ose më të vogël, inspektori vendos llojin korrespondues të nofullës në menu.


2. Matësi është i gatshëm për përdorim pasi kanë përfunduar veprimet e radhitura në pikën 1.

SHTOJCA VII

PËRDORIMI I MATËSIT TË MADHËSISË SË SYZES PËR INSPEKTIM

Kur kryen matjen e syzeve, inspektori:


- a. fut nofullat në hapësirën e syzes, duke vendosur nofullën fikse në pjesën e nyjës, siç është paraqitur në figurën në vijim;
- b. të vërë në funksionim matësin për të mundësuar hapjen e nofullave, deri kur nofulla e lëvizshme arrin nyjën e kundërt dhe bllokohet pasi ka arritur forcën e paracaktuar.



- 1: Madhësia e syzes.
- 2: Drejtimi N.
- 3: Nofulla fikse.
- 4: Nofulla e lëvizshme.

SHTOJCA VIII

FIJET E PËRDREDHURA ÇIFT NË RRJETAT ME SYZE ROMB DHE ATO ME SYZE KUADRATE



VENDIM
(i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. 573, datë 25.6.2020, vendosi shpalljen të vdekur të shtetasit Petro Rondo, i datëlindjes 25.6.1934, më datë 1.1.2020.

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2020

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 252 lekë